



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.7.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË
PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punës, dhe Mirëqenies Sociale, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerina Krasniqi (udhëheqëse ekipi), Alban Shatri, Vjosë Bojku dhe Veton Misiri (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Astrit Bllaca.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit | 6 |
| 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 7 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 11 |
| 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve..... | 24 |
| 5 Qeverisja e mirë..... | 25 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA | 28 |
| Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme | 31 |
| Shtojca III: Letër konfirmimi | 37 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29.09.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i MPMS.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se ishin kryer pagesa të parregullta nga kategoria subvencione dhe transfere në vlerë totale prej 1,913,630€.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrit në auditimin 2017**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e MPMS. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjatë vitit 2017 MPMS kishte kryer pagesa të parregullta nga kategoria subvencione dhe transfere në vlerë totale 1,913,630€. Këto kanë të bëjnë me pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve në vlerë 111,935€, përfituesve të pensioneve nga persona të cilët punojnë apo që realizojnë të ardhura personale në vlerë 921,022€, përfituesve nga më shumë se

një skemë pensionale të financuara nga MPMS-ja në vlerë 701,211€ dhe përfituesve që përfitojnë nga më shumë se një kategori brenda skemës së njëjtë në vlerë 179,462€.

Opinioni i auditimit nuk është kualifikuar për këtë çështje pasi që vlera e gabimit nuk e tejkalon materialitetin e përcaktuar nga ZKA. Për më gjerësisht referojuni nën kapitullit 3.6 Subvencionet dhe Transferet.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MPMS kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesat tjera (kërkesat buxhetore, raportet tremujore duke i përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore dhe planin e prokurimit).

Në PFV-të të MPMS janë identifikuar gabimet si në vijim:

- Tek tabela e ekzekutimit të buxhetit, shënimi 12, grantet dhe ndihmat në kolonën e realizimit të buxhetit ishin prezantuar shpenzimet e vitit në vlerë 276,603€, ndërsa vlera që do të duhej të paraqitet në PFV është vetëm realizimi për vitin 2017 në vlerë 258,930€, (kemi një mbivlerësim prej 17,673€); dhe
- Në PFV ishin prezantuar dy konteste si detyrime kontingjente në vlerë 13,304€, ndërsa sipas regjistrit të detyrimeve kontingjente të MPMS, numri i konteksteve deri në fund të vitit 2017 ishte 667 konteste, të cilat nuk i kanë shumat e vlerësuara.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I MINISTRISË

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç gabimeve jo materiale në PFV të prezantuara më lartë dhe të gjeturës tek theksimi i çështjes e cila është paraqitur tek nën kapitulli 2.1 Opinioni i Auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimi lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

- Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Po ashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e granteve dhe detyrimeve kontingjente sipas shumës së vlerësuar. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Ministria në përgjithësi, ka vendosur kontrole për menaxhim financiar dhe kontroll, mirëpo fusha e prokurimit vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat në fillimin e procedurave të prokurimit. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi i buxhetit dhe menaxhimi i subvencioneve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ¹ | 2017 Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|----------------------------|--------------------|----------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Burimet e Fondeve: | 375,749,474 | 401,277,547 | 400,156,325 | 376,550,042 | 315,278,581 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 375,749,474 | 400,958,625 | 399,879,722 | 376,407,020 | 315,275,283 |
| Donacionet e jashtme | - | 318,922 | 276,603 | 143,022 | 3,298 |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 25,528,073€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme në vlerë 318,922€, rritjes së aplikuar pas rishikimit buxhetor 23,049,518€ dhe me vendimet e Qeverisë 2,159,634€. Në këtë rritje ka ndikuar ndarja e mjeteve për mbulimin e obligimeve tek skema e veteranëve të luftës.

Në vitin 2017, MPMS ka shpenzuar 99.7% të buxhetit final ose 400,156,325€, ngjashëm me vitin me vitin 2016. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2017 Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|---|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 375,749,474 | 401,277,547 | 400,156,325 | 376,550,042 | 315,278,581 |
| Pagat dhe Mëditjet | 4,970,177 | 4,950,177 | 4,872,972 | 4,848,167 | 5,104,701 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 1,772,538 | 2,146,694 | 1,926,237 | 3,058,654 | 2,304,590 |
| Shërbimet komunale | 377,085 | 377,085 | 316,560 | 342,875 | 379,254 |
| Subvencionet dhe Transferet | 367,191,674 | 392,985,005 | 392,236,724 | 367,754,672 | 305,718,653 |
| Investimet Kapitale | 1,438,000 | 818,587 | 803,832 | 545,674 | 1,771,383 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final në krahasim me atë fillestar për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 20,000€, si rezultat i shkurtimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 98%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbimeve ishte më i lartë se ai fillestar për 374,156€. Këtu përfshihet transferi prej kategorisë së investimeve kapitaleve me vlerë 165,000€, rritjes me vendim të qeverisë 285,484€ dhe përfshirjes së donacioneve të jashtme me vlerë 31,900€. Në anën tjetër ishte zvogëluar me shkurtime-kursime buxhetore 108,228€. Në këtë kategori në fund të vitit kishte një suficit prej 220,457€, përderisa kishte edhe obligime të papaguara me arsyetimin se kishte mungesë të mjeteve;
- Tek shpenzimet komunale nuk ka ndryshim të buxheti final me atë fillestar, ndërsa realizimi ishte 84% ;
- Buxheti final krahasuar me atë fillestar për subvencione dhe transfere ishte më i lartë për 25,793,331€. Ndryshimi kaq i madh kishte ardhur si rezultat i ndarjes 26,189,518€ me rishikim të buxhetit për mbulimin e obligimeve tek skema e veteranëve të luftës dhe shkurtimeve buxhetore 3,000,000€ tek skema e pensioneve të pjesëtarëve të policisë, pastaj rritjes me vendim të Qeverisë për 2,364,663€ si dhe donacioneve të jashtme 239,150€; dhe
- Kishte një diferencë të theksuar ndërmjet buxhetit final dhe atij fillestar tek kategoria e investimeve kapitale, ku buxheti final ishte më i ultë për 619,413€. Fillimisht kishte zvogëlim me rishikim me vlerë 120,000€, pastaj me vendim të Qeverisë kishte shkurtime në këtë kategori në vlerë 547,285€. Ndërkaq, kishte një rritje për 47,872€ nga donacionet e jashtme. Realizimi i buxhetit ishte 98%.

Çështja 3 – Realizimi i buxhetit

E gjetura

Pavarësisht ekzekutimit të buxhetit në nivelin 100%, planifikimi i buxhetit ka hapësirë për përmirësim, sidomos tek subvencionet dhe transferet dhe investimet kapitale. Kjo për shkak se tek subvencionet dhe transferet ishte e nevojshme të shtohen shuma të konsiderueshme mjetesh në buxhet, ndërsa tek investimet kapitale ishte shfaqur nevoja për përshtatje të shumta përgjatë vitit. Diferenca të theksuara ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final tek investimet kapitale është si rrjedhojë e planifikimit jo të duhur të projekteve dhe vonesat në realizimin e procedurave.

Po ashtu, ndër sfidat kryesore me të cilat është përballur MPMS-ja gjatë vitit 2017 ishte mungesa e buxhetit për pagesën e obligimeve ndaj veteranëve të luftës, dhe mos planifikimi i buxhetit për pagesën e pensioneve familjare dhe pensioneve invalidore të punës. Pagesa për dy të fundit është dashur të fillojë që nga momenti i pranimit të aplikacioneve për këto skema, pasi që përfituesve ju njihet e drejta e pagesës që nga momenti i aplikimit. Përkundër vështirësive buxhetore, në fund të vitit 2017 ministria ka arritur të sigurojë mjetet për shlyerjen e obligimeve të veteranëve të luftës. Ndërsa, sa i përket pensioneve familjare dhe pensioneve invalidore të punës, ato kanë filluar të paguhen në vitin 2018 me formën një plus një (1+1), që do të thotë një pension i muajit përkatës dhe një pension retroaktiv për shlyerjen e borxhit.

Rreziku

Planifikimi jo i duhur i buxhetit mund ta vë Ministrinë në vështirësi buxhetore si pasojë e mungesës së kapaciteteve financiare për t'i kryer obligimet ligjore për skemat pensionale dhe ato sociale. Kjo po ashtu mund të shpijë deri tek paditë e ndryshme ndaj ministrisë si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve duke rezultuar me detyrime kontingjente të cilat ndikojnë në buxhetin e viteve pasuese.

Rekomandimi 3

Ministri duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për planifikimin jo të duhur të projekteve dhe vonesat në realizimin e procedurave për investime kapitale në 2017 dhe më herët si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Poashtu, duhet të sigurojë që të thellohet dialogu me MF-në rreth planifikimit të buxhetit me theks të veçantë tek skemat sociale dhe pensionale në mënyrë që të evitohen vështirësitë e vazhdueshme në realizimin e obligimeve ligjore dhe të synimeve paraprakisht të caktuara.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPMS në 2017 ishin në vlerë 329,374€. Krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje prej 33%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga Autoriteti i Inspektoratit të Punës (AIP) dhe Departamenti për Punë dhe Punësim (DPP)..

Tabela 3. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2017 Pranimet | 2016 Pranimet | 2015 Pranimet |
|----------------------|-------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Të hyrat jo tatimore | - | - | 329,374 | 247,958 | 200,126 |

Të hyrat e inkasuara derdhen në buxhetin e Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga Ministria.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MPMS-së, e të cilat ndërliken me autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori, barazimet me thesarin etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme.

Çështja 4 – Aplikimi i koeficienteve të ndryshëm për pozita të njëjta

E gjetura Nga shqyrtimi i listës së punonjësve të MPMS, kemi konstatuar se, në shumë raste ishin aplikuar kompensime me koeficient të ndryshëm për pozita të njëjta². Për më tepër, në njërin nga këto raste për pozitën “Zyrtar i pensioneve dhe beneficioneve” ishin aplikuar gjashtë lloje të koeficienteve, duke filluar nga 5.5, 6, 6.5, 7.5, 8 dhe 10.

² Këshilltar – koeficienti 5.5, 6 dhe 6.5, Këshilltar për punësim - koeficienti 6 dhe 6.5, Nëpunës për informim - koeficienti 5, 5.5 dhe 6, Trajner – koeficienti 6.5 dhe 7, Kuzhinier - koeficienti 6.5 dhe 7, Udhëheqës i Zyrës së punësimit – koeficienti 7.5 dhe 8, Nëpunës i regjistrimit – koeficienti 5.5 dhe 6, Zyrtar logjistike - koeficienti 5 dhe 6, Zyrtar administrativ – koeficienti 6, 6.5 dhe 7, Koordinator – koeficienti 6, 6.5 dhe 7, Nëpunës i pensioneve dhe beneficioneve - koeficienti 5.5, 6 dhe 6.5, Zyrtar i pensioneve dhe beneficioneve – koeficienti 5.5, 6, 6.5, 7.5, 8 dhe 10. Zyrtar për pensione te jashtme – koeficienti 5.5 dhe 6.5, Zyrtar i bazës së të dhënave – koeficienti 7 dhe 8, Zyrtar për vendime dhe pagesa – koeficienti 5.5 dhe 6.5, Asistent administrativ - koeficienti 5 dhe 5.5, Depoist - koeficienti 4, 5 dhe 5.5, Mbrojtës Rezidente e Viktimave - koeficienti 5.5 dhe 6.5, Ndihmëse Mjekësore - koeficienti 4 dhe 5, Therapeute e punës - koeficienti 5 dhe 6, , Vozitës – koeficienti 5 dhe 6, Zyrtaret financiar – koeficient 6 dhe 7, Udhëheqës divizioni - koeficienti 9 dhe 10, Udhëheqës institucioni - koeficienti 8 dhe 9, Udhëheqës departamenti - koeficienti 9 dhe 10.

-
- Rreziku** Mos harmonizimi i koeficienteve dhe pagesave të zyrtarëve për pozitat e njëjta, ndikon në cilësinë e punëve të kryera nga zyrtarët përkatës, dëmtim të buxhetit dhe në arritjen e objektivave të organizatës si tërësi.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë që pagesa e zyrtarëve bëhet sipas përshkrimit të detyrave të punës, duke shmangur kështu mundësinë e pagesave të ndryshme për pozitat e njëjta.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme.

Çështja 5 - Procedurat e rekrutimit

- E gjetura** MPMS kishte 32 persona të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV). Në bazë të ligjit për shërbimin civil të Kosovës, këto i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për to duhet të zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Ne kemi parë se 25 prej tyre janë angazhuar pa procedura të rekrutimit, dhe për 20 nga ta, kontratat janë vazhduar çdo 6 muaj prej viteve të kaluara. Arsyeja e angazhimit të këtyre punëtorëve ishte mungesa e buxhetit për paga dhe mëditje. Vlen të theksohet se, me këshillën tonë në memon e auditimit, MPMS në vitin 2018 ka reduktuar numrin e MSHV-ve në dy zyrtarë.
- Rreziku** Angazhimi i punëtorëve me MSHV pa procedura adekuate të rekrutimit, rrit rrezikun që të angazhohen personat jo kompetent për pozitat përkatëse dhe kjo mund të rezultojë në mos efikasitet operacional dhe mosarritje të objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta angazhohen me procedura rekrutuese sipas kërkesave ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 2,523,779€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,242,797€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, shërbime, mirëmbajtje dhe shërbime komunale. Nga testimet tona identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja 6 – Mangësi gjatë përpilimit të specifikacioneve teknike

E gjetura Tek kontrata “Shërbimet e përkthimit për nevojat e MPMS”, në vlerë 62,495€ kemi konstatuar se, kishte mos përputhje në mes të kërkesës nga njësia kërkuese për sasinë dhe njësinë matëse të shërbimeve me specifikacionin teknik të dosjes së tenderit. Më tej, kontrata për këto shërbime nuk përmban artikujt me çmimet për njësi dhe sasinë e parashikuar të shërbimeve që do të pranohen.

Në kontratën kornizë “Servisimi dhe mirëmbajtja e 86 automjeteve të MPMS” në vlerë 41,998€, në specifikacionin teknik të dosjes së tenderit sasia e specifikuar ishte vetëm për një njësi sipas llojit të automjeteve dhe përfshinte 19 lloje, ndërsa çmimi totali i kontratës nuk përfshin çmimin total të servisimit të të gjitha njësive/automjeteve për të cilat është lidhur kontrata, psh. për shtatë vetura të njëjta ka paraparë një filtër ajri, një vaj motori, një filtër karburanti etj.

Rreziku Mos përputhja e kërkesës nga njësia kërkuese me specifikacionet teknike dhe mos përfshirja e sasisë dhe çmimeve për njësi në kontratë, rrezikon dëmtimin e buxhetit dhe mund të rezultojë me humbje financiare dhe mosarritje të vlerës për para. Mos përfshirja e sasive indikative në specifikacionin e dosjes së tenderit mund të rezultojë me shpenzime shtesë apo tejkalim të vlerës së lejuar të kontratës kornizë (30%) dhe dëmtim në arritjen e objektivave të ministrisë

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë se njësitë kërkuese bëjnë një analizë të detajuar të nevojave para se të iniciohen procedurat e prokurimit, duke siguruar kështu se në specifikacionin teknik përfshihen vetëm pozicionet e kërkuara. Po ashtu kontrata duhet të përmbajë sasinë dhe çmimin për njësi komform specifikacionit teknik të dosjes së tenderit. Gjithashtu duhet të siguroj se, në specifikacionin teknik të dosjes së tenderit përfshihen sasi të indikative dhe se kontrata kornizë nënshkruhet në pajtim LPP.

Çështja 7 - Furnizime me barna që nuk janë pjesë e kontratës

- E gjetura** MPMS kishte lidhur kontratë kornizë në afat 24 muaj për furnizime me barna për Shtëpinë e Pleqve në Prishtinë, Institutin Special të Shtimes, Shtëpitë e Komuniteteve dhe Strehimoren në Lipjan. Nga institucionet përkatëse janë bërë kërkesat për furnizim me barna, ndërkohë që në listat e kërkesës janë përfshirë edhe barna të cilat nuk kanë qenë pjesë e kontratës. Komisioni për pranimin e mallit, i emëruar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm kishte pranuar barnat në bazë të porosisë dhe jo në bazë të kontratës, ndërkaq, pagesat për barnat e porositura, por të pa kontraktuara nuk ishin ekzekutuar nga ana e Zyrtarit Certifikues. Si rezultat i kësaj, nga ana e Thesarit janë ekzekutuar pagesa në vlerë 36,101€.
- Rreziku** Porositja dhe pranimi i mallrave të cilat nuk kanë qenë pjesë e kontratës, ka bërë që faturat e pranuar për këto mallra të ekzekutohen direkt nga Thesari dhe e gjithë kjo të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe rrjedhimisht mos përmbushje të objektivave të përcaktuara të MPMS.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme për të siguruar rregullsinë dhe efikasitetin e çdo procesi përmes së cilit kalon një shpenzim, duke reduktuar kështu mundësinë e ekzekutimit të pagesave nga Thesari.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Kategorisë së subvencioneve dhe transfereve i takojnë 98% e shpenzimeve të përgjithshme të MPMS-së. Këto kanë të bëjnë me skemat pensionale dhe sociale, pensionet e parakohshme, subvencionet për përfitues individual dhe publik, etj. Falë bashkëpunimit me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe me Bashkësinë Islame, gjatë vitit 2017 ministria kishte arritur që t'i reduktojë në masë të madhe pagesat për pensionistët pas vdekjes dhe disa nga pagesat e parregullta të cilat ishin identifikuar nga auditimet e viteve paraprake, tek disa skema pensionale dhe sociale. Megjithatë mbetet sfidë edhe më tej menaxhimi i skemave, me theks të veçantë tek përfituesit e dyfishtë si dhe pagesat e pensioneve për personat e punësuar.

Vlera e gabimit total për vitin 2017 ishte 1,913,630€. Ndërsa krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje të pagesave të parregullta në vlerë prej 1,233,199€. Nga testimet tona identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja 8 – Pagesa e pensioneve për personat e vdekur**E gjetura**

Sipas Ligjeve përkatëse të skemave pensionale dhe rregullave të aplikueshme, pensionet duhet të ndalen pas vdekjes së përfituesve. Nga krahasimi i të dhënëve ndërmjet MPMS dhe ARC-së, kemi konstatuar se gjatë vitit 2017, pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve, arrin vlerën 111,935€. Krahasuar me vitin e kaluar, është shënuar një rënie e lehtë e rasteve të tilla të pa rregullta për 3,071€. Kjo ka ndodhur për shkak se vdekjet paraqiten/lajmërohen me vonesë ne ARC, ndërsa ne momentin e krahasimit të të dhënave nga ne, në vlerën e gabimit përfshihen edhe muajt kur personi ka qenë i vdekur por ende i paregjistruar ne ARC. Ky fakt pamundëson eliminimin e tërësishëm të gabimit në këtë skemë nga ana e ministrisë.

Tabela 4. Pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve

| Lloji i pensionit (skemës pensionale) | Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para 2017 | | Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë 2017 | | Total gabimi financiar 2017 | |
|--|--|---------------|---|---------------|--------------------------------|----------------|
| | Numri i pagesave | Shuma (€) | Numri i pagesave | Shuma (€) | Numri i pagesave | Shuma (€) |
| | a | b | c | d | (a+c) | (b+d) |
| Kompensim për persona të verbër (KV) | 53 | 13,250 | 10 | 2,375 | 63 | 15,625 |
| Pensionet Bazë (PB) | 175 | 13,725 | 406 | 31,575 | 581 | 45,300 |
| Pensionet Kontributive (PK) | 58 | 10,280 | 143 | 25,250 | 201 | 35,530 |
| Pensionet për personat me aftësi të Kufizuara (PPAK) | 114 | 8,850 | 55 | 4,950 | 169 | 13,800 |
| Pensionet Trepça | 11 | 1,155 | 5 | 525 | 16 | 1,680 |
| Gjithsej | 411 | 47,260 | 619 | 64,675 | 1030 | 111,935 |

Rreziku

Mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave të pensioneve, rezulton me pagesa të parregullta dhe me dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi 8

Ministri duhet të siguroj se janë përforcuar edhe më tutje kontrollet e brendshme, për të siguruar pastrimin e listave, duke bërë krahasimin sistematik të regjistrave me regjistrin civil, komunikim në kohë reale me shënimet e tyre, para se të bëhet kompensimi i pensioneve. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë.

Çështja 9 – Përfitime të pensioneve nga persona të punësuar

E gjetura Nga krahasimi i regjistrave ndërmjet MPMS-së dhe ATK-së, kemi konstatuar se ekzistojnë raste të përfitimit të pensioneve nga persona të cilët punojnë apo që realizojnë të ardhura personale. Vlera e gabimit për këtë vit ishte 921,022€, që krahasuar me vitin paraprak, është rritur për 515,570€. Kjo ka ndodhur për shkak se ministria në momentin e pagesës nuk e kishte informatën se përfituesi ka punuar në muajin përkatës, pasi që deklarimi i punëtorëve në ATK bëhet deri me datën 15 të muajit vijues.

Tabela 5. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar

| Lloji i skemës pensionale | Numri i pagesave | Gabimi Financiar |
|--|------------------|------------------|
| Pensionet për personat me aftësi të Kufizuara (PPAK) | 2,393 | 201,675 |
| Pensionet Trepça | 509 | 53,550 |
| DFDIL Veteran | 3,382 | 593,820 |
| Ndihma Sociale | 788 | 71,977 |
| Gjithsej | 7,072 | 921,022 |

Rreziku Përfitimi i pensioneve dhe ndihmave sociale nga persona të punësuar është në kundërshtim me ligjin, si dhe shkakton pagesa të parregullta dhe dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të siguroj forcimin e mëtejshëm të kontrolleve të brendshme, me qëllim të pastrimit të listave, në mënyrë që personat e punësuar të mos përfitojnë pensionet që nuk ju takojnë. Duhet të bëhen krahasimet sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK, komunikim në kohë reale, para ekzekutimit të pagesave. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme ndaj përfituesve, në mënyrë që mjetet e përfituara pa bazë ligjore të kthehen në buxhetin e ministrisë.

Çështja 10 – Përfituesit e dyfishtë të skemave pensionale

E gjetura Edhe më tej vazhdon të ketë përfitues nga më shumë se një skemë pensionale të financuara nga MPMS-ja. Rastet më të shumta të këtyre përfitueseve i takojnë kategorisë së TMK-së dhe FSK-së. Vlera e gabimit për këtë vit ishte 701,211€, që krahasuar me vitin paraprak, është rritur për 541,238€.

Tabela 6. Përfituesit e dyfishtë të skemave pensionale

| Përfituesit | Numri i pagesave | Gabimi Financiar |
|--|------------------|------------------|
| Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovë (FSK) | 378 | 106,998 |
| Pensionet Bazë (PB) | 256 | 22,350 |
| Pensionet Kontributive (PK) | 27 | 4,801 |
| Pensionet për personat me aftësi të Kufizuara (PPAK) | 5 | 375 |
| Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) | 2,466 | 556,829 |
| DFDIL Familjar | 2 | 256 |
| DFDIL Veteran | 96 | 9,602 |
| Gjithsej | 3,230 | 701,211 |

Përveç të gjeturave të paraqitura në tabelë, tek Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (DFDIL), ne kemi identifikuar 82 raste të përfituesve që përfitojnë nga më shumë se një kategori brenda skemës së njëjtë. Vlera e gabimit financiar për vitin 2017 për këto raste është 179,462€.

Rreziku Pagesat e pensioneve të dyfishta për personat e njëjtë, janë në kundërshtim me ligjin, dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të kontrolleve të brendshme për të krijuar një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale. Të analizohen mundësitë për krijim të një softueri të integruar të të gjitha skemave pensionale, në mënyrë që të eliminohet mundësia e përfitimeve të dyfishta të pensioneve. Po ashtu duhet të merren të masat ligjore në mënyrë që përfituesit t'i kthejnë mjetet e përfituara jashtëligjshëm në buxhetin e ministrisë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 818,587€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 803,832€. Ato kryesisht kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve për raste sociale. Nga testimet tona identifikuam çështjen në vijim:

Çështja 11 - Përzgjedhja e OE të pa përgjegjshëm

E gjetura Në dy³ raste, MPMS kishte shpërblyer me kontratë OE të cilët nuk i kishin plotësuar të gjitha kriteret sipas dosjes së tenderit. OE fitues nuk kishin dëshmi mbi pronësinë e makinerisë së listuar dhe mjeteve të punës të nevojshme për realizimin e punëve.

Rreziku Përzgjedhja e OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret, ndikon në zvogëlimin e besueshmërisë së procesit dhe mund të rezultojë me shërbime jo cilësore nga mungesa e makinerisë dhe mjeteve të punës, po ashtu mund të ketë edhe vonesa në realizimin e kontratës.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kontratat lidhen me OE të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurisë kapitale mbi 1,000€ në regjistrin kontabël ishte 19,008,812€, ndërsa vlera neto e pasurive jo kapitale nën 1,000€ ishte 758,990€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Çështja 12 - Dobësi në menaxhimin e pasurive

E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar disa mos pajtueshmëri lidhur me menaxhimin e pasurive të Ministrisë si në vijim:

- Megjithëse ishte formuar komisioni për inventarizimin e pasurive të Ministrisë në fund të vitit, ai nuk kishte përfunduar punën me kohë, dhe puna e tij nuk ishte bërë në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Mungonte ndërlidhja/krahasimi i shënimeve nga raporti i inventarizimit dhe zyrtarit të pasurisë.

³ "Ndërtimi I QAP Podujeve"- 149,614€ dhe "Renovimi i kulmit APK-Gjakove"- 14,885€

- Ministria kishte lidhur marrëveshje mirëkuptimi me Komuna të ndryshme për ndërtimin e objekteve për banim social. Mirëpo, si rezultat i mungesës së qartë të pronësisë së këtyre objekteve në marrëveshjet e bashkëfinancimit me Komunat, edhe pse dihet se këto janë pronë e Komunës, kanë mbetur pa u bartur pasuri në vlerë 136,748€. Një pjesë e tyre figuron në regjistrin e pasurisë së MPMS si investime në vijim, ndërkaq pjesa tjetër është paraqitur si pasuri në përdorim (kjo pasi që, pagesa ka qenë e barabartë me vlerën e kontratës);
- Në një rast, pasuria në vlerë 14,511€, (ndërtesa banimi) nuk figuron në regjistrin e pasurisë së MPMS;
- Më tej, në pesë raste në vlerë 35,908€, renovimi i pasurisë është regjistruar si pasuri e re (objekt), ndërsa do të duhej t'i bashkëngjitej vlerës bazë të objektit. E njëjta situatë është edhe me mbikëqyrjen e projekteve që nuk ishte bashkëngjitur projekteve bazë, mirëpo, në një rast ishte regjistruar si investim në vijim, ndërsa në një tjetër si ndërtesa afariste.
- Pagesa për projektin ideor në vlerë 11,129€ ishte regjistruar si investime në vijim në regjistrin e pasurisë, edhe pse projekti ka përfunduar; dhe
- Për 14 nga 40 mostrat e kërkuara të pasurisë, të cilat janë të paraqitura në regjistrin e pasurisë, që ishin pasuri të regjistruara në vitet e mëhershme (para vitit 2010), ministria nuk ka ofruar dokumentacion mbështetës për to.

Rreziku

Mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë, mungesa e dokumenteve mbështetëse për pasuritë e paraqitura në regjistër, regjistrimet jo adekuate si dhe mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël, rrisin rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi 12

Ministri duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i tyre të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Më tutje, duhet të sigurojë se në marrëveshjet e bashkëfinancimit me komunat, të qartësohet pronësia e objekteve të ndërtuara pas përfundimit. Gjithashtu duhet të shtohet bashkëpunimi i Zyrtarit të pasurisë me Thesarin për të mundësuar regjistrimin e investimeve të reja në objektet ekzistuese si vlerë e shtuar e objektit bazë.

3.9 Të arkëtueshmet

Të hyrat e pa mbledhura të MPMS të prezantuara në PFV ishin 398,253€. Ato kanë të bëjnë me gjobat e shqiptuara nga inspektorati i punës. Krahasuar me vitin e kaluar llogaritë e arkëtueshme janë rritur për 195,503€ (2016 - 202,503€), kjo rritje ishte si rezultat i rritjes së numrit të gjobave të shqiptuara nga inspektorati i punës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 422,051€, që është për 206,323€ (33%) më e vogël krahasuar me vitin paraprak. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. MPMS nuk kishte kontrollë të mjaftueshme në menaxhimin e obligimeve të papaguara.

Çështja 13 - Raportim jo i plotë dhe dobësi në menaxhimin e obligimeve

E gjetura Nga faturat e paguara në vitin 2018 (periudha Janar-Mars) të cilat ishin obligime të vitit 2017, ne kemi konstatuar se në një rast, fatura në vlerë prej 2,586€ nuk ishte prezantuar në raportin e obligimeve të viti 2017. Po ashtu në pesë raste kishte tejkalim të afatit ligjor (30 ditë) për pagesën e obligimeve të prezantuara në PFV. Vonesa të tilla variojnë nga 13 deri në 103 ditë vonesë. Kjo ka ndodhur pasi që, MPMS nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit të faturave, ngase në shtatë mostra të testuara faturat e pranuar nuk ishin protokolluar ashtu siç kërkohet me Rregulloren Financiare 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike. Më tej, raportimi i obligimeve nuk ishte bërë sipas formës së kërkuar nga Rregullorja Financiare 02/2013 për raportimin e obligimeve, sepse këto raporte nuk ishin nënshkruar.

Rreziku Raporti jo i plotë i obligimeve të pa paguara, dhe tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund të rezultojë me humbje të faturave dhe rrjedhimisht MPMS nuk do të ketë informacionin e duhur dhe në kohë lidhur me obligimet paraprake, po ashtu ministria mund të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve. Po ashtu duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar protokollohen.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

MPMS ka pranuar rekomandimet tona për auditimin e vitit 2016, në qershor 2017 dhe një plan veprimi, është përpiluar për zbatim të këtyre rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, nga 15 rekomandimet e dhëna në vitin 2016, pesë rekomandime janë zbatuar, një është në proces të zbatimit ndërsa nëntë nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 15 rekomandime, prej të cilave tetë ishin zbatuar dhe shtatë të pa zbatuara. Përderisa nuk janë zbatuar rekomandimet e vitit 2016 dhe ato të viteve të mëhershme, mangësitë në sistemet domethënëse mbesin të pa trajtuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 14 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Ne nuk kemi vërejtur se MPMS aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në:

- Planifikim të dobët të buxhetit në fushën e subvencioneve dhe investimeve kapitale; dhe
- Mangësi në menaxhimin e pasurive, personelit dhe prokurimit.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MPMS veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit nuk ishin vendosur plotësisht. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme, dhe Komiteti i Auditimit është funksional.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës. Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohet se është e vendosur pjesërisht nga ana e MPMS-së, për arsye se strategjia është Draft Strategji e cila nuk është e miratuar nga Qeveria dhe si e tillë nuk ka mundur të gjej zbatim nga e ana e Ministrisë.

Edhe pse MPMS ka hartuar një regjistër të rreziqeve, ai nuk i mbulon të gjitha aktivitetet dhe përmbajta e tij nuk menaxhohet në mënyrë aktive për sa i përket azhurnimit dhe sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të zbutur rreziqet.

Sa i përket raportit të vetëvlerësimit MPMS ka dorëzuar atë në Ministrinë e Financave në afatin e paraparë.

Vlen të përmendet se gjatë vitit 2017 ministria ka blerë një softuer për integrimin e bazës së të dhënave të pensioneve të DFIDL-së (pensionet e luftës) dhe DPSF (pensionet sociale), i cili hap do të ndihmojë në menaxhimin më të mirë të këtyre skemave.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditor. NjAB kishte përfunduar 20 auditimet e planifikuara, si dhe kishte kryer një auditim shtesë me kërkesë të menaxhmentit.

Çështja 15 - Dokumentim i dobët i dosjes së auditimit nga NjAB

E gjetura Ne kemi rishikuar dosjen e raportit të auditimit të NjAB “për shtëpinë e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, Prishtinë” dhe kemi parë se, në dosjen e auditimit nuk ishin bashkangjitur dëshmitë dhe dokumentet mbështetëse për të gjeturat e auditimit.

Rreziku Mos dokumentimi i raporteve të auditimit të NjAB me dëshmitë dhe dokumentet mbështetëse të nevojshme do të dëmtoj efektivitetin e punës së NjAB dhe do të zvogëloj mundësinë që ZKA të marrë siguri nga puna e NjAB, përkundër volumit dhe cilësisë së punës së ndërmarrë.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të sigurojë se një rishikim i kontrollit të cilësisë do të aplikohet për çdo dosje të auditimit nga Drejtori i NjAB dhe duhet të sigurohet se në raportin vjetor të KA do të shqyrtohet cilësia e dosjeve të auditimit të aplikuara nga NjAB.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

MPMS ka nën menaxhimin e saj shtatë qendra rajonale të Departamentit të Administratës Pensionale, shtatë qendra rajonale të punësimit dhe tetë qendra për aftësim profesional. Raportimi financiar dhe operativ bëhet përmes departamenteve përkatëse. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportim me kohë. Në kuadër të MPMS vepron edhe Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës si dhe nga viti 2018 ka filluar të funksionojë si agjenci edhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës. Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 16 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Edhe pse procesi i raportimit nga ana e departamenteve në Ministri është javor dhe i rregullt, raportet përveç që nuk janë gjithëpërfshirëse, ato nuk shqyrtohen dhe konsiderohen nga menaxhmenti i lartë në mënyrë që të sigurohet llogaridhënie efektive. Raportet nuk përmbajnë nivel të informatave që do të mundësonin menaxhim efektiv të aktiviteteve, për shkak se nuk ekziston ndonjë raportim standard. Kjo ka ndodhur sepse llogaridhënia relative mes MPMS dhe zyrave/qendrave të saj dhe përgjegjësitë përcjellëse për raportim janë të kufizuara dhe nuk zbatohen në mënyrë efektive. Po ashtu, takimet e mbajtura nga Sekretari i Përgjithshëm me drejtorët e departamenteve, nuk mbulohen me procesverbale.

Sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, MPMS duhet të ketë një regjistër të rreziqeve. Megjithatë, edhe pse regjistri i rreziqeve është hartuar, ai nuk i mbulon të gjitha aktivitetet dhe përmbajta e tij nuk menaxhohet në mënyrë aktive për sa i përket azhurnimit dhe sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të zbutur rreziqet. Për menaxhimin efektiv të rrezikut nevojiten veprime të qarta, të cilat duhet të zbatohen për të gjitha rreziqet domethënëse që kanë ndikim tek organizata

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontroleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, MPMS duhet të plotësojë dhe azhurnoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat veprimet e duhura për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

| Komponenta e Auditimit | Rekomandimet e bartura nga viti 2015 | Të zbatuara gjatë vitit 2017 | Në proces të zbatimit gjatë 2017 | Të pa zbatuara |
|--|--|------------------------------|----------------------------------|--|
| 2.5.2 Raportimi Menaxherial | Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i formës aktuale të e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, dhe të sigurojë se raportimi i departamenteve të standardizohet dhe plotësohet me informatat e nevojshme, për të mbështetur një menaxhim më efektiv të veprimtarisë. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit | Ministri duhet të sigurojë që të thellohet dialogu me Ministrinë e Financave rreth planifikimit të buxhetit me theks të veçantë tek skemat sociale dhe pensionale në mënyrë që të evitohen vështirësitë e vazhdueshme në realizimin e obligimeve ligjore dhe të synimeve paraprakisht të caktuara. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 3.5.3 Subvencionet dhe Transferet | Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprimet e duhura në mënyrë që të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në pastrimin e listave, duke bërë krahasimin e vazhdueshëm sistematik të regjistrave me regjistrin civil, në baza mujore, para se të bëhet kompenzimi i pensioneve. Poashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |

| | | | | |
|---|--|--|--|--|
| 3.5.3 Subvencionet dhe Transferet | Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprimet e duhura për të siguruar forcimin e kontrolleve të brendshme në pastrimin e listave të pensioneve nga personat e punësuar, duke bërë krahasimet sistematike të shënimeve me ATK, para ekzekutimit të pagesave. Poashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 3.5.3 Subvencionet dhe Transferet | Ministri duhet të sigurojë se do të vazhdoj forcimin e kontrolleve të brendshme duke krijuar sistem më efektiv të komunikimit të data bazave ndërmjet skemave pensionale. Të shikohen mundësitë për krijim të një softueri të integruar të të gjitha skemave pensionale, në mënyrë që të eliminohet mundësia e përfitimeve të dyfishta të pensioneve. Po ashtu duhet të merren të masat ligjore në mënyrë që përfituesit ti kthejnë mjetet e përfituara jashtëligjshëm në buxhetin e ministrisë. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 3.7 Pasuritë dhe detyrimet | Ministri duhet të sigurojë që në të ardhmen, komisioni i inventarizimit të formohet në nivel të organizatës, dhe të kryejë punën sipas kërkesave ligjore në mënyrë që vlera e pasurive në PVF të jetë e plotë dhe e saktë. Duhet të shtohen aktivitete për përfshirjen e të gjitha pasurive në regjistrat kontabël dhe në e-pasuria. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 3.7.2 Trajtimi i borxheve | Ministri duhet të iniciojë një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, për tu siguruar se do të bëhet vlerësim sistematik i borxheve dhe do të merren masat adekuate për përmirësim të gjendjes aktuale. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |

| Komponenta e auditimit | Rekomandimet e dhëna në vitin 2016 | Të zbatuara | Në proces të zbatimit | Të pa zbatuara |
|--|--|----------------------------|-----------------------|--|
| 2. Pasqyrat Financiare | Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në gabimet e prezantuara në PFV. Duhet të ndërmerren veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për ta siguruar inventarizimin e rregullt të të gjitha pasurive dhe shpалosjen e saktë të vlerës së pasurive dhe detyrimeve në PFV. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak | Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së | Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i pyetësit të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. | Rekomandimi është zbatuar. | | |
| 2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia | Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim specifik për të përcaktuar një formë më të përshtatshme të raportimit tek menaxhmenti i lartë, për të rritur efikasitetin e raporteve dhe kontrolleve. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |

| | | | | |
|--|---|----------------------------|--|--|
| 2.4.Sistemi i auditimit të brendshëm | Ministri duhet të siguroj funksionimin efektiv të KA, për të përkrahur NjAB-në në realizimin e objektivave, dhe për ta ndihmuar menaxhmentin në zbatimin e rekomandimeve të auditimit. | Rekomandimi është zbatuar. | | |
| 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit | Ministri duhet të sigurojë që të thellohet dialogu me MF-në rreth planifikimit të buxhetit me theks të veçantë tek skemat sociale dhe pensionale në mënyrë që të evitohen vështirësitë e vazhdueshme në realizimin e obligimeve ligjore dhe të synimeve paraprakisht të caktuara. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 3.1.2 Pagat dhe mëditjet | Ministri duhet të sigurojë se janë respektuar afatet ligjore në rastet e ushtrimit të pozitave të caktuara dhe që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për plotësimin me kohë të pozitave me staf të rregullt. | Rekomandimi është zbatuar. | | |
| 3.1.2 Pagat dhe mëditjet | Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë (6) muaj. | | Rekomandimi i zbatuar pjesërisht, pasi që nga shtatori 2017, ministria nuk ka vazhduar kontratat për MSHV ekzistues dhe prej kësaj kohe nuk ka as të angazhuar të rinj. Kjo ka ndikuar në reduktimin e numrin të MSHV në dy raste në vitin 2018. | |
| 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale | Ministri duhet të sigurojë se para secilit aktivitet të prokurimit fillimisht të konfirmohet disponueshmëria e mjeteve. Përveç kësaj specifikat teknike duhet të jenë të qarta për të mundësuar kontraktimin dhe furnizimin me artikuj adekuat sipas kërkesave të njëjësive kërkuese. | Rekomandimi është zbatuar. | | |

| | | | | |
|---|---|----------------------------|--|---|
| 3.1.4 Subvencionet dhe transferet | Ministri duhet të sigurojë se janë përforcuar edhe më tutje kontrollet e brendshme, për të siguruar pastrimin e listave, duke bërë krahasimin sistematik të regjistrave me regjistrin civil, në baza mujore, para se të bëhet kompensimi i pensioneve. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017 |
| 3.1.4 Subvencionet dhe transferet | Ministri duhet të sigurojë forcimin e mëtejshëm të kontrolleve të brendshme, me qëllim të pastrimit të listave, në mënyrë që personat e punësuar të mos përfitojnë pensionet që nuk ju takojnë. Duhet të bëhen krahasimet sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK, para ekzekutimit të pagesave. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme ndaj përfituesve, në mënyrë që mjetet e përfituara pa bazë ligjore të kthehen në buxhetin e ministrisë. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017 |
| 3.1.4 Subvencionet dhe transferet | Ministri duhet të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të kontrolleve të brendshme për të krijuar një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale. Të analizohen mundësitë për krijim të një softueri të integruar të të gjitha skemave pensionale, në mënyrë që të eliminohet mundësia e përfitimeve të dyfishta të pensioneve. Po ashtu duhet të merren të masat ligjore në mënyrë që përfituesit t'i kthejnë mjetet e përfituara jashtëligjshëm në buxhetin e ministrisë. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017 |
| 3.1.4 Subvencionet dhe transferet | Ministri duhet të sigurojë që komisionet vlerësuese bëjnë vlerësime objektive të projekteve, dhe se asnjë subjekt nuk do të subvencionohet nëse nuk i plotëson kërkesat e parapara me konkurse dhe me rregulloret përkatëse të subvencioneve. | Rekomandimi është zbatuar. | | |

| | | | | |
|---------------------------|---|--|--|--|
| 3.2 Pasuritë | Ministri duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë e që menaxhimi dhe raportimi i tyre të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Me tutje duhet të sigurojë se procesi i bartjes së pronësisë së objekteve të ndërtuara të kompletohet me nënshkrimin e dokumentacionit nga të gjitha palët e përfshira në proces. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |
| 3.3 Obligimet e papaguara | Ministri duhet të sigurojë se është bërë një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, dhe të bëjë një vlerësim të menjëhershëm të obligimeve, për të marrë masa adekuate për përmirësimin e gjendjes aktuale. | | | Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017. |

Shtojca III: Letër konfirmimi

| | |
|---|----|
| REPUBLIKA E KOSOVËS QEVERIA E VLADE Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite | |
| No. Prot. 256 Data 25.06.18 | 02 |



| | | | |
|--|----|------|---|
| REPUBLIKA E KOSOVËS ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE | | | |
| 25.06.2018 | | | |
| 03 | 47 | 1165 | 2 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite/Ministry of Labour and Social Ėelfare

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem në parim me të gjeturat dhe rekomandimet dhe për përmbajtjen e Raportit;
- Megjithatë, konsideroj se është dashur të bëhet një shqyrtim i hollësishëm në lidhje me përfituesit e pensioneve nga personat e punësuar që janë në Skemën e Pensioneve për Personat me Aftësi të Kufizuar, pasi që legjislacioni aktual nuk e ndalon përfitimin e pensionit për aftësi të kufizuar për personat e punësuar në këtë skemë. Gjithashtu, edhe të çështja e përfitimit të pensionit të Veteranit nga personat që janë të punësuar, konsideroj se edhe pse është i saktë konstatimi që të njëjtit persona që kanë përfituar pension të veteranit të njëjtën kohë kanë qenë të punësuar për shkak të mosharhozimit me kohë të të dhënave me

Administratën Tatimore të Kosovës dhe me Trustin Pensional të Kosovës, mirëpo çështja e gabimit financiar duhet të rishikohet, sepse në momentin që është vërejtur që përfituesi i pensionit të veteranit ka qenë i punësuar, është bërë ndalesa e pagesës në muajin vijues.

- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Skender Reçica

Ministër - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Data: 25 Qershor 2018, Prishtinë,